



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Arsimit dhe Shkencës
Ministarstvo Obrazovanja i Nauke / Ministry of Education and Science

Korniza e Kompetencës Digjitale për Mësimdhënësit në Kosovë



Co-funded by the
European Union

Përmbajtja

Shkurtesat	3
Përmbledhje	4
1 Hyrje.....	6
2 Qëllimi i kësaj kornize	9
3 Kompetenca digjitale	10
4 Pasqyrë e kompetencës digjitale të mësimdhënësve në Kosovë	11
5 Korniza e kompetencës digjitale për Kosovën – Fushat dhe kompetencat.....	13
6 Tregues i shkathtësive digjitale	21
6 Kohëzgjatja e trajnimit	26
ANEKSI 1 – Module të Pilotuara.....	28

Shkurtesat

TKAEDITE – Transforming Kosovo and Albanian Education through Digital Transformation and Education, tkaedite.eu

LNU – Linnaeus University

UNESCO – Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë

NTNU – Universiteti Norvegjez i Shkencës dhe Teknologjisë

TIK – Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit

DigComp – Korniza Evropiane për Kompetencën Digjitale

DigCompEdu – Korniza Evropiane për Kompetencën Digjitale të Edukatorëve

VR – Realiteti Virtual

AR – Realiteti i Shtuar

IA (AI) – Inteligjenca Artificiale

TPACK – Njohuri Teknologjike, Pedagogjike dhe të Përbajtjes

CC – Licencat Creative Commons

LMS – Sistem për Menaxhimin e Mësimit

Moodle – Platformë LMS me burim të hapur

SAMR – Model për integrimin e teknologjisë në mësimdhënie (zëvendësim, përmirësim, modifikim, ripërcaktim)

STEM – Shkencë, Teknologji, Inxhinieri dhe Matematikë

UDL – Dizajni Universal për të Nxënit

WCAG – Udhëzime për aksesueshmërinë e përmbajtjes në web

NAO – Robot humanoid edukativ

Përmbledhje

Ky dokument paraqet Kornizën e Kompetencës Digjitale për Mësimdhënësit në Kosovë, e zhvilluar si një produkt kyç i projektit TKAEDITE.eu, në mbështetje të iniciativave kombëtare në Kosovë për zhvillimin e kompetencave digjitale në arsim. Korniza është hartuar në mënyrë bashkëpunuese nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës të Kosovës, Universitetin e Prizrenit, partnerë nga BE-ja, Universitetin Linneause në Suedi, Universitetin e Oulus në Finlandë dhe Universitetin NTNU në Norvegji, si dhe partnerë nga Shqipëria, Universitetin e Tiranës dhe Universitetin Politeknik të Tiranës.

E harmonizuar me Kornizën Evropiane të Kompetencës Digjitale për Mësimdhënës (DigCompEdu) dhe kornizat e UNESCO-s për mësimdhënësit dhe praktikantët më të mira ndërkombëtare. Kjo nismë siguron që mësimdhënësit në Kosovë të përvetësojnë aftësitë e nevojshme për integrimin efektiv të teknologjive digjitale në mësimdhënie dhe nxënie. Po ashtu, ajo është në përputhje me prioritetet kombëtare për digjitalizimin e arsimit, duke mbështetur transformimin e metodave pedagogjike, komunikimit dhe bashkëpunimit në klasë.

Para propozimit të Kornizës së Kompetencës Digjitale për Mësimdhënësit në Kosovë, u realizua një studim hulumtues për të krijuar një pasqyrë të qartë mbi gjendjen aktuale të kompetencave digjitale të mësimdhënësve. Pas këtij procesi, partnerët e projektit TKAEDITE.eu organizuan një punëtori për hartimin e Kornizës së Kompetencës Digjitale për Mësimdhënësit në Kosovë. Korniza u përshtat në një strukturë të ndarë në shtatë fusha kyçe, secila e zbërthyer më tej në komponentë specifike:

- **Dimensionet** – që përcaktojnë aspektet specifike të kompetencës
- **Kompetenca** – që përshkruajnë aftësitë që mësimdhënësit pritet t'i zhvillojnë
- **Aftësitë** – që përshkruajnë njohuritë dhe shkathtësitë e nevojshme për arritjen e kompetencave
- **Shembuj konkretë** – që ilustrojnë mënyrën se si mësimdhënësit dhe nxënësit i zbatojnë këto aftësi në praktikë.

Zhvillimi i kompetencës digjitale të mësimdhënësve në Kosovë është një hap thelbësor për përmirësimin e cilësisë së arsimit dhe për sigurimin e përdorimit efektiv të mjeteve digjitale sinkrone dhe asinkrone, si dhe atyre të përforcuara me inteligjencë artificiale, në procesin mësimor.

Kjo nismë nxit zhvillimin profesional, duke fuqizuar si mësimdhënësit para-shërbimit ashtu edhe ata në shërbim për t'u orientuar dhe përshtatur me mjediset digjitale të nxënies në vazhdimësi.

Kjo kornizë përbën një dokument fillestar, i cili mund të përditësohet vazhdimisht në bazë të hulumtimeve arsimore, avancimeve të politikave dhe zhvillimeve teknologjike, duke siguruar kështu relevancën e saj të vazhdueshme dhe përshtatjen ndaj nevojave në zhvillim të mësimdhënësve dhe nxënësve në Kosovë.

1 Hyrje

Në kontekstin e sotëm digjital që po zhvillohet me ritme shumë të shpejta, pajisja e mësimdhënësve me kompetenca digjitale është thelbësore për ndërtimin e sistemeve arsimore inovative dhe gjithëpërfshirëse. Në nivel global, zhvillimet në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit (TIK) konsiderohen pjesë përbërëse e procesit të transformimit digjital, si dhe ndikojnë drejtpërdrejt në mënyrat se si njohuritë transmetohen dhe përvetësohen. Në përgjigje të këtyre transformimeve, Kosova ka ndërmarrë disa hapa strategjikë për modernizimin e sektorit të arsimit, me theks të veçantë në zhvillimin e shkathtësive digjitale të mësimdhënësit dhe nxënësit.

Duke e njohur nevojën për një qasje sistematike ndaj arsimit digjital, Kosova është përafuar me standardet dhe kornizat kryesore evropiane. Një nga referencat kryesore në këtë drejtim është Korniza Evropiane për Kompetencën Digjitale të Edukatorëve (DigCompEdu), e zhvilluar nga Komisioni Evropian. Kjo kornizë ofron një gjuhë të përbashkët dhe një model të strukturuar për vlerësimin dhe zhvillimin e kompetencave digjitale të nevojshme për mësimdhënie dhe nxënie efektive në epokën digjitale. Megjithatë, ndonëse Korniza e Kompetencës Digjitale për Mësimdhënësit (DigCompEdu) ofron një bazë të fortë, ajo nuk adreson plotësisht integrimin e teknologjive të avancuara si inteligjenca artificiale, realiteti virtual, realiteti i shtuar dhe mjetet digjitale në zhvillim, të cilat po ndikojnë gjithnjë e më shumë në praktikën arsimore në mbarë botën. Për këtë arsye, Korniza e Kompetencës Digjitale për Mësimdhënësit në Kosovë mbështetet gjithashtu dhe krahasohet me korniza të tjera ndërkombëtare, përfshirë DigCompEdu, Kornizën e Kompetencës në TIK të UNESCO-s për Mësimdhënësit dhe Kornizën e Kompetencës në IA të UNESCO-s për Mësimdhënësit. Duke analizuar këto referenca globale, kjo kornizë e përditësuar siguron që mësimdhënësit në Kosovë të jenë të përgatitur jo vetëm për kërkesat digjitale të sotme, por edhe për pasqyrën teknologjike dhe pedagogjike që po evoluon me shpejtësi.

Para propozimit të Kornizës së Kompetencës Digjitale për Mësimdhënësit në Kosovë, u zhvillua një fazë e rëndësishme përgatitore përmes një studimi hulumtues kombëtar i cili kishte për qëllim vlerësimin e nivelit ekzistues të kompetencave digjitale të mësimdhënësit e arsimit parauniversitarë në Kosovë, si dhe identifikimin e boshllëqeve, nevojave dhe mundësive kryesore për zhvillim të mëtejshëm. Në studim morën pjesë një mostër e gjerë dhe përfaqësuese prej 1602 mësimdhënësish të arsimit parauniversitar. Mbledhja e të dhënave u realizua përmes instrumentit SELFIE – një mjet i njohur dhe i ndërtuar në përputhje me kornizën DigCompEdu, i cili vlerëson mënyrën se si teknologjitë digjitale integrohen në praktikën mësimore. Për të siguruar vlefshmërinë

dhe ndjeshmërinë kulturore të instrumentit, SELFIE u përkthye në gjuhën shqipe dhe u validua përmes një studimi pilot me 441 pjesëmarrës të udhëhequr nga Fakulteti i Edukimit, Universiteti i Prishtinës. Kjo përshtatje e kujdesshme garantoj që instrumenti të pasqyrojë kontekstin gjuhësor dhe arsimor vendor, duke ruajtur njëkohësisht rigorozitetin dhe standardet e versionit origjinal. Procesi i validimit forcoi besueshmërinë e të dhënave dhe krijoi një bazë të fortë empirike për hartimin e mëvonshëm të Kornizës së Kompetencës Digjitale për Mësimdhënësit në Kosovë.

Gjetjet e studimit ofruan njohuri të rëndësishme mbi gjendjen e kompetencave digjitale të mësimdhënësve në Kosovë (shih seksionin 4). Pavarësisht përpjekjeve të konsiderueshme për përmirësimin e infrastrukturës dhe qasjes në internet në shkolla, studimi tregoi se shumë mësimdhënës ende përballen me sfida në integrimin efektiv të mjeteve digjitale në mësimdhënie. Rezultatet e vetëvlerësimit për 22 kompetencat e kornizës DigCompEdu treguan një nivel mesatar të përvetësimit, duke nënvizuar nevojën për programe të synuara të zhvillimit profesional. Në veçanti, kompetencat që lidhen me krijimin e përmbajtjeve digjitale, zgjidhjen e problemeve përmes teknologjisë dhe shkrim-leximin kritik digjital u identifikuan si fusha që kërkojnë mbështetje më të madhe.

Duke u mbështetur në gjetjet e studimit dhe në praktikat më të mira evropiane, Korniza e Kompetencës Digjitale për Mësimdhënësit në Kosovë, u përshtat në një strukturë të ndarë në shtatë fusha kryesore. Secila fushë pasqyron një dimension kritik të kompetencës digjitale duke filluar nga angazhimi profesional dhe menaxhimi i burimeve digjitale, deri te vlerësimi, fuqizimi i nxënësve dhe lehtësimi i zhvillimit të shkathtësive digjitale të vetë nxënësve.

Korniza e Kompetencës Digjitale për Kosovën synon të shërbejë për qëllime të shumëfishta. Ajo ofron një model referues për institucionet e përgatitjes së mësimdhënësve, politikëbërësit dhe shkollat, duke siguruar që zhvillimi i kompetencave digjitale të bëhet pjesë integrale dhe e matshme e arsimit të mësimdhënësve dhe e rritjes së tyre profesionale. Për më tepër, ajo mbështet ambiciet më të gjera të Kosovës të përcaktuara në Planin Strategjik të Arsimit 2022–2026, ku digjitalizimi i arsimit është pozicionuar si një objektivi strategjik kyç. Përmes kësaj nisme, Kosova ndërmerri një hap të rëndësishëm drejt modernizimit të sistemit të saj arsimor, duke siguruar që mësimdhënësit të jenë të përgatitur mirë për të përmbushur kërkesat e mësimdhënies bashkëkohore.

Në përfundim, zhvillimi i Kornizës së Kompetencës Digjitale për Mësimdhënësit në Kosovë, i mbështetur në hulumtim rigoroz dhe i harmonizuar me standardet evropiane, përfaqëson

një moment kyç. Kjo kornizë pasqyron një përkushtim të fortë për ndërtimin e një sistemi arsimor të gatshëm për të ardhmen, ku shkathhtësitë digjitale nuk shihen më si opcionale, por si elemente thelbësore të mësimdhënies dhe nxënies efektive.

2 Qëllimi i kësaj kornize

Korniza e Kompetencës Digjitale për Mësimdhënësit në Kosovë, synon të vendosë një qasje të standardizuar dhe të bazuar në kompetenca për zhvillimin dhe vlerësimin e shkathtësive digjitale dhe njohurive pedagogjike të mësimdhënësve të arsimit parauniversitar. Ajo ofron një udhërrëfyes të qartë për përmirësimin e praktikave mësimore në TIK, duke i harmonizuar ato me praktikatat më të mira ndërkombëtare, politikat kombëtare të arsimit, si dhe me Kornizën Evropiane dhe globale të Kompetencës Digjitale për Edukatorët (DigCompEdu).

Kjo kornizë është hartuar për të:

- **Fuqizuar mësimdhënësit e arsimit parauniversitar** me shkathtësitë e nevojshme për integrimin efektiv të teknologjive digjitale dhe atyre të përforcuara me inteligjencë artificiale në procesin mësimor.
- **Rritur shkrim-leximin digjital të nxënësve**, duke siguruar që mësimdhënësit të jenë të pajisur me kompetenca adekuate digjitale.
- **Standardizuar kompetencat digjitale të mësimdhënësve**, në përputhje me objektivat e reformës arsimore në Kosovë dhe Shqipëri, si dhe me strategjinë kombëtare të digjitalizimit.
- **Mbështetur zhvillimin e vazhdueshëm profesional** dhe ofruar shtigje të strukturuar për trajnimin dhe certifikimin e mësimdhënësve në kompetenca digjitale.
- **Nxitur inovacionin në mësimdhënie**, përmes përfshirjes së teknologjive në zhvillim si Inteligjenca Artificiale (IA), Realiteti i Shtuar (AR), Realiteti Virtual (VR) dhe mjetet arsimore të bazuara në Cloud.
- **Siguruar qasje gjithëpërfshirëse në arsimin**, për nxënës atipik, përfshirë edhe ata me nevoja të veçanta arsimore.

3 Kompetenca digjitale

Kompetenca digjitale përfshin shkathtësitë, njohuritë dhe qëndrimet e nevojshme për sukses në arsim, në jetën profesionale dhe në pjesëmarrjen qytetare në një botë teknologjike që po zhvillohet me shpejtësi. Sipas Vizionit për Arsimin Digjital të Shkollave Evropiane, kompetenca digjitale duhet të zhvillohet te çdo nxënës. Si një nga tetë kompetencat kyçe të përcaktuara në dokumentin “*Kompetencat kyçe për të nxënit gjatë gjithë jetës në shkollat evropiane*”, kompetenca digjitale u prezentua fillimisht në vitin 2006 dhe u përditësua në vitin 2018 nga Parlamenti Evropian dhe Këshilli Evropian si vijon:

“Kompetenca digjitale përfshin përdorimin dhe angazhimin e sigurt, kritik dhe të përgjegjshëm me teknologjitë digjitale për të nxënit, në punë dhe për pjesëmarrje në shoqëri. Ajo përfshin shkrim-leximin e informacionit dhe të dhënave, komunikimin dhe bashkëpunimin, shkrim-leximin mediatik, krijimin e përmbajtjeve digjitale (përfshirë programimin), sigurinë (përfshirë mirëqenien digjitale dhe kompetencat që lidhen me sigurinë kibernetike), çështjet që lidhen me pronësinë intelektuale, zgjidhjen e problemeve dhe mendimin kritik.”

(Rekomandimi i Këshillit për Kompetencat Kyçe për të Nxënit gjatë Gjithë Jetës, 22 maj 2018, ST 9009 2018 INIT)

Këto kompetenca ndërthurin njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet. Ato përbëhen nga koncepte dhe fakte (njohuri), aftësi praktike (shkathtësi), si dhe mënyra të menduarit ose prirje për veprim (qëndrime). Kompetencat kyçe zhvillohen vazhdimisht gjatë gjithë jetës. Sipas dokumentit “*Digital Education Vision for the European Schools*”, kompetenca digjitale duhet të zhvillohet te çdo nxënës:

“Çdo nxënës dhe student, gjatë gjithë arsimit të tij/saj në Shkollat Evropiane, zhvillon kompetencën digjitale për të nxitur përdorimin dhe angazhimin e sigurt, kritik, të përgjegjshëm dhe kreativ me teknologjitë digjitale për të nxënit, në punë dhe për pjesëmarrje në shoqëri.”

Për të arritur këtë vizion, mësimdhënësit duhet të marrin rolin udhëheqës në përvetësimin dhe forcimin e kompetencës së tyre digjitale, duke u siguruar që janë të përgatitur për të mbështetur çdo nxënës në arritjen e objektivave të arsimit digjital në shkollat e tyre. Për këtë arsye, kjo kornizë shërben si një burim kyç për orientimin e hartimit të aktiviteteve arsimore dhe trajnuese të fokusuara në ndërtimin e kompetencës digjitale.

4 Pasqyrë e kompetencës digjitale të mësimeve në Kosovë

Kompetenca digjitale është shndërruar në një shkathtësi themelore për mësimeve në Kosovë, duke reflektuar prirjet globale drejt integritit të teknologjisë në arsim. Studimet e fundit, të bazuara në korniza si DigCompEdu dhe TPACK (Njohuri Teknologjike, Pedagogjike dhe të Përmbytjes), tregojnë se, ndonëse mësimeve në Kosovë demonstrojnë një nivel mesatar të përvetësimit në përdorimin e burimeve digjitale, ende ekzistojnë boshllëqe në fusha si integrimi pedagogjik, vlerësimi dhe fuqizimi i nxënësve përmes teknologjisë.

Të dhënat e mbledhura nga 26 komuna të Kosovës nxjerrin në pah dallime në kompetencën digjitale sipas moshës dhe përvojës, ku mësimeve në mes të karrierës zakonisht shfaqin shkathtësi më të zhvilluara në përzgjedhjen dhe menaxhimin e burimeve digjitale. Në përgjithësi, mësimeve në komuna të ndryshme treguan nivele të ngjashme të kompetencës digjitale. Rezultatet nuk treguan dallime domethënëse ndërmjet mësimeve të cilitdo nivel të arsimit parauniversitar në asnjë nga fushat, duke nënkuptuar se faktori i komunës nuk pati ndikim të konsiderueshëm në kompetencën digjitale (shih Figurën 1).




Figura 1: Kompetencat digjitale në komunat kryesore të Kosovës

Në të kundërt, u vërejtën dallime domethënëse ndërmjet grupeve të moshës në Fushën 2 (Burimet Digjitale) dhe Fushën 5 (Fuqizimi i Nxënësve), duke treguar se mosha ka pasur ndikim në kompetencat e mësimeve në këto fusha (shih figurën 2).




Figura 2: Kompetencat digjitale sipas kategorive të moshës

Këto gjetje theksojnë nevojën urgjente për programe të synuara të zhvillimit profesional në fushën e kompetencave digjitale, veçanërisht në domenin “Mësimdhënie dhe Nxënie”, me qëllim ndërtimin e kapaciteteve të mësimdhënësve për integrimin efektiv të mjeteve digjitale në praktikën mësimore në klasë. Ndërsa kornizat ekzistuese ofrojnë baza të vlefshme për të kuptuar kompetencën digjitale të mësimdhënësve, ato nuk adresojnë plotësisht integrimin e teknologjive që po zhvillohen me shpejtësi, përfshirë inteligjencën artificiale, realitetin virtual dhe të shtuar, si dhe gamifikimin në praktikën arsimore. Për më tepër, konteksti specifik i Kosovës kërkon korniza që janë të ndjeshme ndaj sfidave lokale, burimeve në dispozicion dhe dinamikave kulturore.

Në këtë kontekst, korniza e Kosovës synon të mbulojë boshllëqe kritike përmes përcaktimit të kompetencave që adresojnë teknologjitë në zhvillim, etikën, gjithëpërfshirjen dhe integrimin pedagogjik të mjeteve digjitale. Ajo ofron udhëzime të qarta për zhvillimin profesional të mësimdhënësve dhe mbështet përpjekjet sistimore drejt transformimit digjital, inovacionit dhe qasjes së barabartë në arsim cilësor në të gjithë Kosovën. Zhvillimi i kësaj kornize të përshtatur në nivel kombëtar për mësimdhënësit përbën një hap vendimtar për të siguruar që sistemi arsimor i Kosovës të mbetet i qëndrueshëm, fleksibil dhe i gatshëm për të ardhmen në një epokë të ndryshimeve të shpejta teknologjike.

5 Korniza e Kompetencës Digjitale për Kosovën – Fushat dhe kompetencat

Korniza është e strukturuar në shtatë fusha kyçe, të cilat përfshijnë dimensione, kompetenca dhe shkathtësi që mësimdhënësit duhet t'i zhvillojnë. Secila fushë ofron shembuj konkretë për të dy rolet – nxënësit dhe mësimdhënësit – me qëllim ilustrimin e zbatimeve praktike në procesin mësimor.

Lista e fushave:

Fusha 1: Angazhimi Profesional

Fusha 2: Infrastruktura Digjitale e Klasës dhe Mbështetja Institucionale

Fusha 3: Zhvillimi Profesional dhe Kompetencat Digjitale

Fusha 4: Krijimi dhe Menaxhimi i Përmbajtjeve Digjitale

Fusha 5: Siguria Digjitale, Etika dhe Përdorimi i Përgjegjshëm

Fusha 6: Teknologjitë në Zhvillim dhe Gatishmëria për të Ardhmen

Fusha 7: Fuqizimi i Nxënësve

Fusha 1: Angazhimi profesional - Përdorimi i teknologjive digjitale për komunikim, bashkëpunim dhe zhvillim profesional.

Dimensioni 1:	Informimi, Komunikimi, Bashkëpunimi dhe Përafrimi me Politikrat
Kompetenca:	Përdorimi i mjeteve digjitale për ndërveprim profesional, për të ndërtuar rrjete bashkëpunimi, për t'u përafruar me kornizat e politikave dhe për të modeluar praktika efektive digjitale.
Shkathtësitë	<ol style="list-style-type: none">1. Të jetë i/e aftë të kërkojë, gjejë dhe përdorë materiale digjitale për përmirësimin e zhvillimit profesional.2. Të jetë i/e aftë të përdorë mjete digjitale për komunikim dhe bashkëpunim.3. Të jetë i/e aftë të ofrojë informatë kthyesë për nxënësit dhe kolegët përmes mjeteve digjitale.4. Të jetë i/e aftë të bashkë-hartojë materiale mësimore me kolegët.

	<p>5. Të përdorë njohuritë dhe udhëzimet praktike për përdorimin e mjeteve digjitale në përputhje me mjedisin mësimor.</p> <p>6. Të kuptojë dhe zbatojë kornizat kombëtare, evropiane dhe globale të politikave në praktikat digjitale.</p>
Shembuj konkretë:	<p><i>Në kontekst mësimor (nxënësi):</i></p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi përdor platforma digjitale për hulumtim, gjetjen e burimeve arsimore online dhe pjesëmarrje në diskutime. Nxënësi merr pjesë në aktivitete bashkëpunuese digjitale, si projekte grupore online, bashkëredaktim dokumentesh ose ndarje prezentimesh. <p><i>Në kontekst mësimdhënës (mësimdhënësi):</i></p> <ul style="list-style-type: none"> Mësimdhënësi krijon kanale online për komunikim me nxënësit dhe kolegët. Mësimdhënësi organizon takime virtuale dhe forume diskutimi për të nxitur bashkëpunimin profesional. Mësimdhënësi ofron feedback digjital përmes sistemeve të menaxhimit të nxënies, email-it ose mjeteve interaktive të vlerësimit.

Fusha 2: Infrastruktura digjitale dhe mbështetja institucionale

Dimensioni 2:	Qasja në mjete digjitale, politikat institucionale dhe infrastruktura e gatshme për IA
Kompetenca:	Navigimi në sisteme digjitale, për të mbështetur respektimin e politikave institucionale dhe për të avokuar për përmirësimin e infrastrukturës, përfshirë gatishmërinë për inteligjencë artificiale.
Shkathësitë:	<ol style="list-style-type: none"> Të jetë i/e aftë të navigojë dhe të zgjidhë problemet bazë të infrastrukturës digjitale të ofruar nga shkollat. Të jetë i/e aftë të përzgjedhë dhe të integrojë mjete digjitale të përshtatshme.

	<p>3. Të jetë i/e aftë të sigurojë respektimin e politikave për mbrojtjen e të dhënave dhe etikën.</p> <p>4. Të jetë i/e aftë të ofrojë udhëzime për kolegët mbi përdorimin e mjeteve digjitale në dispozicion dhe gatishmërinë institucionale për IA.</p>
Shembuj konkretë:	<p><i>Në kontekst mësimor (nxënësi):</i></p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi qaset në burime digjitale përmes platformave dhe mjeteve të ofruara nga shkolla. Nxënësi respekton udhëzimet për sigurinë digjitale dhe etikën gjatë përdorimit të burimeve online. <p><i>Në kontekst mësimdhënës (mësimdhënësi):</i></p> <ul style="list-style-type: none"> Mësimdhënësi përdor tabela interaktive, shërbime cloud dhe sisteme të menaxhimit të nxënies për shpërndarjen e përmbajtjes. Mësimdhënësi mbështet kolegët në përzgjedhjen e mjeteve digjitale më efektive për nevoja të ndryshme mësimore. Mësimdhënësi siguron që politikat digjitale të respektohen gjatë mbledhjes dhe shpërndarjes së të dhënave të nxënësve.

Fusha 3: Zhvillimi profesional dhe kompetencat digjitale

Dimensioni 3:	Nxënia, zhvillimi dhe rritja e kompetencës në IA
Kompetenca:	Përmirësimi i vazhduar i shkathtësive digjitale, për t'u angazhuar me mjete digjitale dhe të përforcuara me inteligjencë artificiale, për të ndarë praktikat më të mira dhe për të mentoruar kolegët në integrimin e përgjegjshëm të teknologjisë digjitale
Shkathtësitë:	<p>1. Të jetë i/e aftë të marrë pjesë në mundësi të nxënies profesionale online, si webinarë dhe programe digjitale të certifikimit.</p> <p>2. Të jetë i/e aftë të vlerësojë dhe të përzgjedhë programe trajnimi digjital me cilësi të lartë, të përshtatshme për praktikën e tij/saj mësimore.</p>

	<p>3. Të jetë i/e aftë të kontribuojë në trajnimin e kolegëve duke ndarë praktika dhe strategji më të mira për përdorimin e mjeteve digjitale dhe atyre të IA-së në mësimdhënie.</p>
Shembuj konkretë:	<p><i>Në kontekst mësimor (nxënësi):</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Nxënësi angazhohet në module ose tutoriale online me ritëm individual të të nxënit. • Nxënësi merr pjesë në aktivitete të të nxënit ndërmjet bashkëmoshatarëve përmes mjeteve digjitale. <p><i>Në kontekst mësimdhënës (mësimdhënësi):</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Mësimdhënësi përfundon kurse të zhvillimit profesional në pedagogjinë digjitale. • Mësimdhënësi mentoron kolegët në adoptimin e mjeteve digjitale për mësimdhënie në klasë. • Mësimdhënësi kontribuon në strategjitë institucionale për zhvillimin e kompetencës digjitale.

Fusha 4: Krijimi dhe menaxhimi i përmbajtjeve digjitale

Dimensioni 4:	Kërkimi, krijimi dhe shpërndarja e burimeve digjitale
Kompetenca:	Aftësia për të gjetur, krijuar, përshtatur dhe shpërndarë burime digjitale në mënyrë të përgjegjshme.
Shkathësitë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Të jetë i/e aftë të kërkojë, vlerësojë dhe integrojë burime arsimore digjitale me cilësi të lartë. 2. Të jetë i/e aftë të krijojë përmbajtje digjitale të përshtatura me nevojat mësimore të nxënësve, duke përdorur mjete multimediale dhe të përforcuara me inteligjencë artificiale. 3. Të jetë i/e aftë të ruajë dhe shpërndajë materiale në mënyrë etike (licencimi, atribuimi).

	4. Të kuptojë të drejtat e autorit dhe implikimet e tyre (licencat Creative Commons).
Shembuj konkretë:	<p><i>Në kontekst mësimor (nxënësi):</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Nxënësi përzgjedh burime digjitale relevante për detyra hulumtuese. • Nxënësi krijon projekte multimediale duke përdorur mjete digjitale të përshtatshme. <p><i>Në kontekst mësimdhënës (mësimdhënësi):</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Mësimdhënësi dizajnon dhe shpërndan prezantime interaktive, video dhe kuize. • Mësimdhënësi përdor burime arsimore të hapura (OER), duke siguruar atribuimin e duhur. • Mësimdhënësi ka njohuri mbi lloje të ndryshme të licencave të së drejtës së autorit dhe di si të gjejë materiale mësimore duke përdorur licenca të ndryshme.

Fusha 5: Siguria digjitale, etika dhe përdorimi i përgjegjshëm

Dimensioni 5:	Siguria online, mirëqenia digjitale dhe etika e IA-së
Kompetenca:	Përdorimi i sigurt dhe etik e teknologjive digjitale dhe atyre të përforcuara me inteligjencë artificiale, duke adresuar privatësinë, paragjykimet dhe mirëqenien digjitale.
Shkathësitë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Të jetë i/e aftë të edukojë nxënësit mbi privatësinë online, sigurinë kibernetike dhe sjelljen e përgjegjshme digjitale. 2. Të jetë i/e aftë të njohë dhe të reagojë ndaj bullizmit kibernetik, shqetësimeve për privatësinë e të dhënave dhe kërcënimeve online. 3. Të jetë i/e aftë të zbatojë politikatat institucionale për mirëqenien digjitale dhe sjelljen etike. 4. Të kuptojë implikimet etike të përdorimit të inteligjencës artificiale (paragjykimi, transparenca).

	5. Të jetë i/e aftë të përzgjedhë materiale të përshtatshme për grupe të ndryshme moshe.
Shembuj konkretë:	<p><i>Në kontekst mësimor (nxënësi):</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Nxënësi mëson rreth rreziqeve online, gjurmës digjitale dhe përdorimit të përgjegjshëm të rrjeteve sociale. • Nxënësi ndjek udhëzime etike për ndërveprimet digjitale dhe shpërndarjen e përmbajtjeve. <p><i>Në kontekst mësimdhënës (mësimdhënësi):</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Mësimdhënësi organizon punëtori për sigurinë digjitale për nxënësit dhe prindërit. • Mësimdhënësi zbaton rregulla në klasë për përdorim të sigurt dhe të përgjegjshëm të internetit. • Mësimdhënësi udhëheq iniciativa që promovojnë sjelljen etike online brenda komunitetit shkollor. • Mësimdhënësi vlerëson mjetet e bazuara në IA për rreziqe etike përpara se t'i integrojë ato në aktivitetet mësimore.

Fusha 6: Teknologjitë në zhvillim dhe gatishmëria për të ardhmen

Dimensioni 6:	Pedagogjia e IA-së dhe Integrimi i Teknologjive në Zhvillim
Kompetenca:	Eksplorimi, vlerësimi dhe integrimi i teknologjive në zhvillim, përfshirë inteligjencën artificiale në praktikat mësimore, duke marrë parasysh aspektet etike, pedagogjike dhe inovative.
Shkathësitë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Të jetë i/e aftë të eksplorojë dhe të zbatojë në klasë teknologji të përforcuara me IA, realitet të shtuar (AR) dhe teknologji të tjera në zhvillim. 2. Të jetë i/e aftë të vlerësojë implikimet etike të përdorimit të teknologjive në zhvillim dhe atyre të përforcuara me IA në arsim.

	<p>3. Të jetë i/e aftë të vlerësojë vlerën pedagogjike të mjeteve në zhvillim dhe atyre të përforcuara me IA.</p> <p>4. Të jetë i/e aftë të avokojë për inovacion digjital dhe adoptim të teknologjive të bazuara në hulumtim.</p>
<p>Shembuj konkretë:</p>	<p><i>Në kontekst mësimor (nxënësi):</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Nxënësi eksperimenton me kodim grafik, robotikë ose aplikacione të realitetit të shtuar. • Nxënësi angazhohet në aktivitete praktike të të nxënit duke përdorur teknologji në zhvillim. • Nxënësi eksperimenton me mjete të bazuara në inteligjencë artificiale (p.sh. kuize adaptive, chatbot-e). • Nxënësit reflektojnë në mënyrë kritike mbi ndikimin e IA-së në procesin e tyre të të nxënit. <p><i>Në kontekst mësimdhënës (mësimdhënësi):</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Mësimdhënësi integron mjete të bazuara në IA për të nxënit dhe vlerësimin e personalizuar. • Mësimdhënësi vlerëson teknologjitë e reja arsimore dhe rekomandon praktikat më të mira. • Mësimdhënësi merr pjesë në projekte hulumtuese që eksplorojnë ndikimin e inovacionit digjital.

Fusha 7: Fuqizimi i nxënësve përmes teknologjive digjitale gjithëpërfshirëse dhe të qasshme, duke nxitur kompetencën digjitale dhe në IA të nxënësve

Dimensioni 7:	Qasja, gjithëpërfshirja dhe nxitja e kompetencës digjitale dhe në IA të nxënësve
Kompetenca:	Krijimi i mjediseve digjitale gjithëpërfshirëse, për të siguruar përdorim të barabartë të mjeteve digjitale dhe atyre të përforcuara me inteligjencë artificiale, si dhe për të udhëzuar nxënësit në zhvillimin e praktikave digjitale dhe të IA-së kritike, kreative, etike dhe të përgjegjshme.
Shkathësitë	<ol style="list-style-type: none"> 1. Të jetë i/e aftë të mbështesë nxënësit në përdorimin kritik, kreativ, etik dhe të përgjegjshëm të mjeteve digjitale. 2. Të jetë i/e aftë të përdorë mjete gjithëpërfshirëse të të nxënësve për të kompensuar vështirësi të ndryshme, si p.sh. vështirësitë në lexim. 3. Të jetë i/e aftë të përdorë mjete të qasjes (accessibility tools) të integruara në pajisje digjitale. 4. Të jetë i/e aftë të përzgjedhë mjete, materiale dhe detyra të përshtatshme për nxënës individualë ose grupe nxënësish me nevoja të veçanta arsimore.
Shembuj konkretë:	<p><i>Në kontekst mësimor (nxënësi):</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Nxënësi aktivizon mjete gjithëpërfshirëse të të nxënësve kur ka nevojë. • Nxënësi është i/e aftë të përdorë mjete digjitale në mënyrë kritike, kreative dhe të sigurt. • Nxënësit përdorin aplikacione përkthimi të bazuara në IA për të qasur përmbajtje në gjuhën e tyre amtare. <p><i>Në kontekst mësimdhënës (mësimdhënësi):</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Mësimdhënësi përzgjedh një mjedis mësimor gjithëpërfshirës dhe të qasshëm për të gjithë nxënësit. • Mësimdhënësi prezenton mjetet e duhura për të mbështetur nxënësit me nevoja të qasjes dhe gjithëpërfshirjes.

6 Treguesi i shkathtësive digjitale

Treguesi i shkathtësive digjitale fokusohet në aktivitetet që mësimit kryejnë duke përdorur teknologjitë digjitale, duke u bazuar në supozimin se realizimi i detyrave të caktuara pasqyron zotërimin e shkathtësive përkatëse.

Në përputhje me kornizën DigCompEdu, fokusi vihet te shkathtësitë – aftësia për të kryer detyra dhe për të zgjidhur probleme duke përdorur mjete digjitale. Për të përcaktuar kompetencën digjitale të mësimit, janë vendosur tre nivele progresive të përvetësimit: (i) niveli bazë digjital, (ii) niveli i ndërmjetëm digjital dhe (iii) niveli i avancuar digjital.

Këto nivele përcaktohen përmes një qasjeje të bazuar në kritere, e cila vlerëson shkathtësitë digjitale të mësimit (shih Tabelën 1):

- Shkathtësi digjitale bazë
- Shkathtësi digjitale të ndërmjetme
- Shkathtësi digjitale të avancuara

Tabela 1: Qasja e bazuar në kritere për vlerësimin e shkathtësive digjitale të mësimit dhe përcaktimin e nivelit të përvetësimit të kompetencës digjitale.

Niveli i përvetësimit –	Shkathtësitë
Shkathtësi digjitale bazë	<ol style="list-style-type: none">1. Të jetë i/e aftë të kërkojë, gjejë dhe përdorë materiale digjitale për përmirësimin e zhvillimit profesional.2. Të jetë i/e aftë të përdorë mjete digjitale për komunikim dhe bashkëpunim.3. Të jetë i/e aftë të ofrojë informatë kthyesë për nxënësit dhe kolegët përmes mjeteve digjitale.4. Të jetë i/e aftë të bashkëhartojë materiale mësimore me kolegët.5. Të përdorë njohuritë praktike dhe udhëzimet për përdorimin e mjeteve digjitale në përputhje me mjedisin mësimor.6. Të kuptojë dhe zbatojë kornizat kombëtare, evropiane dhe globale të politikave në praktikën digjitale.

	<ol style="list-style-type: none"> 7. Të jetë i/e aftë të navigojë dhe të zgjidhë problemet bazë të infrastrukturës digjitale të ofruar nga shkollat. 8. Të jetë i/e aftë të përzgjedhë dhe të integrojë mjete digjitale të përshtatshme. 9. Të jetë i/e aftë të sigurojë respektimin e politikave për mbrojtjen e të dhënave dhe etikën. 10. Të jetë i/e aftë të ofrojë udhëzime për kolegët mbi përdorimin e mjeteve digjitale në dispozicion dhe gatishmërinë institucionale për IA. 11. Të jetë i/e aftë të marrë pjesë në mundësi të nxënies profesionale online, si webinarë dhe programe digjitale të certifikimit. 12. Të jetë i/e aftë të vlerësojë dhe të përzgjedhë programe trajnimi digjital me cilësi të lartë, të përshtatshme për praktikën mësimore. 13. Të jetë i/e aftë të kontribuojë në trajnimin e kolegëve duke ndarë praktika dhe strategji më të mira për përdorimin e mjeteve digjitale dhe atyre të IA-së në mësimdhënie.
Shkathtësi digjitale të ndërmjetme	<ol style="list-style-type: none"> 14. Të jetë i/e aftë të kërkojë, vlerësojë dhe integrojë burime arsimore digjitale me cilësi të lartë. 15. Të jetë i/e aftë të krijojë përmbajtje digjitale të përshtatura me nevojat mësimore të nxënësve, duke përdorur mjete multimediale dhe të përforcuara me inteligjencë artificiale. 16. Të jetë i/e aftë të ruajë dhe shpërndajë materiale në mënyrë etike (licencimi, atribuimi). 17. Të kuptojë të drejtat e autorit dhe implikimet e tyre (licencat Creative Commons). 18. Të jetë i/e aftë të edukojë nxënësit mbi privatësinë online, sigurinë kibernetike dhe sjelljen e përgjegjshme digjitale.

	<p>19. Të jetë i/e aftë të njohë dhe të reagojë ndaj bullizmit kibernetik, shqetësimeve për privatësinë e të dhënave dhe kërcënimeve online.</p> <p>20. Të jetë i/e aftë të zbatojë politikat institucionale për mirëqenien digjitale dhe sjelljen etike.</p> <p>21. Të kuptojë implikimet etike të përdorimit të inteligjencës artificiale (paragjykimi, transparenca).</p> <p>22. Të jetë i/e aftë të përzgjedhë materiale të përshtatshme për grupe të ndryshme moshe.</p>
<p>Shkathtësi digjitale të avancuara</p>	<p>23. Të jetë i/e aftë të eksplorojë dhe të zbatojë në klasë teknologji të përforcuara me IA, realitet të shtuar (AR) dhe teknologji të tjera në zhvillim.</p> <p>24. Të jetë i/e aftë të vlerësojë implikimet etike të përdorimit të teknologjive në zhvillim dhe atyre të përforcuara me IA në arsim.</p> <p>25. Të jetë i/e aftë të vlerësojë vlerën pedagogjike të mjeteve në zhvillim dhe atyre të përforcuara me IA.</p> <p>26. Të jetë i/e aftë të avokojë për inovacion digjital dhe adoptim të teknologjive të bazuara në hulumtim.</p> <p>27. Të jetë i/e aftë të mbështesë nxënësit në përdorimin kritik, kreativ, etik dhe të përgjegjshëm të mjeteve digjitale.</p> <p>28. Të jetë i/e aftë të përdorë mjete gjithëpërfshirëse të të nxënit për të kompensuar, për shembull, vështirësitë në lexim.</p> <p>29. Të jetë i/e aftë të përdorë mjete të qasjes (accessibility tools) të integruara në pajisje digjitale.</p> <p>30. Të jetë i/e aftë të përzgjedhë mjete, materiale dhe detyra të përshtatshme për nxënës individualë ose grupe nxënësish me nevoja të veçanta arsimore.</p>

Për shembull, një mësues me **shkathtësi digjitale bazë** mund të kërkojë dhe të përdorë burime digjitale profesionale për të mbështetur zhvillimin e tij/saj të vazhdueshëm, të

marrë pjesë në webinarë ose të fitojë certifikime digjitale, si dhe të vlerësojë cilësinë e programeve të trajnimit digjital që lidhen me praktikën e tij/saj mësimore. Ai/ajo përdor mjete digjitale për komunikim dhe bashkëpunim me kolegët, bashkëharton materiale mësimore dhe ofron një informate kthyesë si për nxënësit ashtu edhe për kolegët. Për më tepër, ky mësimdhënës është i/e aftë të navigoj dhe të zgjidhë problemet bazë të infrastrukturës digjitale të ofruar nga shkolla, të integrojë mjete digjitale të përshtatshme në mësimdhënie dhe në detyra administrative, si dhe të udhëzojë të tjerët për përdorimin efektiv të këtyre mjeteve. Një mësimdhënës i tillë është gjithashtu i vetëdijshëm për standardet etike dhe politikat e mbrojtjes së të dhënave dhe kontribuon aktivisht në trajnimin e kolegëve duke ndarë praktikën dhe strategjitë më të mira brenda komunitetit profesional.

Në **nivelin e ndërmjetëm**, mësimdhënësit fillojnë të shkojnë përtej përdorimit bazë të teknologjisë, duke demonstruar një integrim më të menduar dhe strategjik të saj në praktikën profesionale. Përveç përdorimit të mjeteve digjitale për komunikim, bashkëpunim dhe zhvillim profesional, ata janë të aftë të kërkojnë dhe të vlerësojnë në mënyrë aktive burime arsimore digjitale me cilësi të lartë, duke përzgjedhur ato që mbështesin më së miri nevojat e nxënësve të tyre. Ata krijojnë përmbajtje digjitale angazhuese duke përdorur mjete multimediale, si video, prezantime interaktive dhe materiale vizuale që përmirësojnë përvojën e të nxënësve. Këta mësimdhënës gjithashtu dinë të organizojnë dhe të ruajnë materialet digjitale në mënyrë efikase, duke siguruar qasje të lehtë dhe përdorshme afatgjatë. Për më tepër, ata përqafojnë parimet e ndarjes së hapur duke shpërndarë burimet e tyre përmes licencave Creative Commons, duke nxitur një mjedis mësimor digjital bashkëpunues dhe respektues. Këta mësimdhënës i edukojnë aktivisht nxënësit mbi privatësinë online, sigurinë kibernetike dhe sjelljen e përgjegjshme digjitale. Ata janë të përgatitur të njohin dhe të reagojnë ndaj çështjeve si bullizmi kibernetik, shqetësimet për privatësinë e të dhënave dhe kërcënimet e tjera online. Me një kuptim të fortë të politikave institucionale, ata sigurojnë që mirëqenia digjitale dhe sjellja etike të integrohen në praktikën e përditshme në klasë. Mësimdhënësit e nivelit të ndërmjetëm janë gjithashtu të vetëdijshëm për përmbajtjen e përshtatshme sipas moshës dhe i përshtatin materialet e tyre në përputhje me këtë, duke përzgjedhur burime që respektojnë kufizimet e zakonshme të moshës dhe fazën e ndryshme zhvillimore. Ky nivel pasqyron një rritje të besimit dhe kompetencës në shfrytëzimin e teknologjisë për përmirësimin e mësimdhënies dhe të nxënësve.

Në **nivelin e avancuar**, mësime dhënësit demonstronjë një shkallë të lartë besimi, kreativiteti dhe përgjegjësi në përdorimin e teknologjive digjitale të avancuara. Duke u mbështetur në shkathtësitë e zhvilluara në nivelet bazë dhe të ndërmjetme, ata marrin një rol udhëheqës në ndërtimin e një mjedisi mësimor digjital të sigurt, gjithëpërfshirës dhe të orientuar drejt së ardhmes. Ata eksplorojnë dhe integrojnë teknologji në zhvillim, si inteligjenca artificiale (IA) dhe realiteti i shtuar (AR), në mësimdhënie, duke vlerësuar njëkohësisht në mënyrë kritike implikimet etike të këtyre mjeteve në kontekstin arsimor. Për më tepër, ata avokojnë për praktika digjitale inovative të bazuara në hulumtim dhe promovojnë adoptimin e teknologjive gjithëpërfshirëse. Ata përdorin mjete që mbështesin nxënësit me nevoja specifike, për shembull duke ndihmuar në vështirësi të leximit ose duke përkthyer të folurën dhe tekstin në kohë reale përmes inteligjencës artificiale të përpunimit të gjuhës natyrore. Funkcionalitetet e qasjes të integruara në pajisje shfrytëzohen plotësisht, ndërsa detyrat mësimore përshtaten me kujdes për t'iu përgjigjur nevojave të nxënësve individualë ose grupeve të nxënësve me kërkesa të veçanta. Në çdo aspekt, këta mësime dhënësit modelojnë përsosmëri digjitale dhe udhëheqin përmes shembullit.

6 Kohëzgjatja e trajnimit

Për të mbështetur zhvillimin profesional të mësimitdhënësve, mund të ndiqet një qasje e strukturuar që siguron se mësimitdhënësit, pavarësisht nëse janë në fillim të rrugëtimit të tyre digjital apo tashmë në nivel të avancuar, marrin udhëzimin dhe kohën e nevojshme për zhvillimin e shkathtësive të tyre.

Shkathtësi digjital bazë (20–30 orë):

Ky nivel është i dedikuar për mësimitdhënësit e arsimit fillor K1–5, të cilët kanë përvojë minimale në përdorimin e mjeteve digjitale. Fokusi është në ndërtimin e shkathtësive themelore, si përdorimi i softuerëve arsimorë, menaxhimi i klasave digjitale dhe integrimi i teknologjisë së thjeshtë në praktikatat e përditshme mësimore.

Shkathtësi digjital të ndërmjetme (31–50 orë):

Ky nivel është i projektuar për mësimitdhënësit e klasave 1-12 (K–12) që tashmë janë të njohur me mjetet digjitale, por që kanë nevojë për strategji më të thelluara të integritimit. Mësimitdhënësit në këtë nivel forcojnë aftësinë e tyre për të përdorur teknologjinë në mënyrë më efektive për krijimin e përmbajtjeve digjitale, rritjen e angazhimit të nxënësve, diferencimin e mësimitdhënies dhe përmirësimin e planifikimit të orëve mësimore.

Shkathtësi digjital të avancuara (60+ orë):

Ky trajnim intensiv u dedikohet mësimitdhënësve të TIK-ut që tashmë zotërojnë kompetenca të forta digjitale. Trajnimi fokusohet në aplikime të avancuara, si kodimi, udhëheqja në teknologjinë arsimore dhe mbështetja e kolegëve në proceset e transformimit digjital.

Duke përafuar orët e trajnimit me nivelet e përvetësimit, kjo kornizë siguron një përvojë të personalizuar dhe me ndikim për secilin mësimitdhënës.

Numri i orëve të nevojshme varet nga thellësia e trajnimit:

Niveli i përvetësimit	Orët	Grupi i synuar
Shkathtësi digjital bazë	20–30 orë	Mësimitdhënës me shkathtësi minimale digjitale (Mësimitdhënës të shkollave K1–5)

Shkathësi digjitale të ndërmjetme	31–50 orë	Mësimdhënës të njohur me mjetet digjitale, por që kanë nevojë për shkathësi më të thelluara integrimi (Mësimdhënës të shkollave K1-12)
Shkathësi digjitale të avancuara	60+ orë	Mësimdhënës të TIK-ut

Një program i plotë certifikimi, që mbulon në mënyrë gjithëpërfshirëse të gjitha fushat, mund të kërkojë 100–150 orë.

ANEKSI 1 – Module të Pilotuara

Këtu paraqitet grupi i moduleve trajnuese të pilotuara, të dizajnuara për të forcuar kompetencat digjitale, pedagogjike dhe ato të lidhura me STEM të mësimdhënësve. Modulet mbulojnë fusha kyçe të mësimdhënies online, përfshirë pedagogjinë digjitale, krijimin e materialeve multimediale, vlerësimin online dhe përdorimin e sistemeve të menaxhimit të nxënies (LMS – Moodle), si dhe tema të avancuara si robotika e mbështetur nga inteligjenca artificiale, mendimi kompjuterik, editimi i videove për arsim, dizajni universal dhe qasja digjitale, si dhe integrimi i robotëve humanoidë/socialë në klasë. Së bashku, këto module ofrojnë një kornizë gjithëpërfshirëse të zhvillimit profesional që i pajis mësimdhënësit me mjete moderne dhe inovative për transformimin e mësimdhënies dhe të nxënimit përmes teknologjisë.

Më poshtë janë paraqitur modulet e trajnimit të pilotuara, secili i shoqëruar me një përshkrim të shkurtër:

Moduli 1 – Hyrje në nxënien online

Ky modul i prezanton mësimdhënësit me parimet bazë të nxënies online, përfshirë pedagogjitë digjitale, angazhimin e nxënësve dhe strukturën e klasave virtuale. Pjesëmarrësit eksplorojnë mënyrat se si mjediset online mund të rrisin qasjen dhe fleksibilitetin dhe marrin një orientim fillestar në Moodle. Moduli ndërton besimin për zbatimin e mësimdhënies së kombinuar dhe asaj plotësisht online.

Moduli 2 – Metodatat e mësimdhënies online

Ky modul fokusohet në dizajnimin e orëve mësimore online kuptimplota dhe interaktive. Mësimdhënësit mësojnë të zbatojnë parimet e dizajnit instruksional (përfshirë modelin TPACK ose SAMR), të dizajnojnë aktivitete bashkëpunuese dhe të përdorin mjete digjitale që rrisin pjesëmarrjen e nxënësve. Theksi vihet në qasje adaptive dhe të përqendruara te nxënësi, që mbështesin nxënësin të ndryshëm në mjedise online.

Moduli 3 – Materiale audio-vizuale

Mësimdhënësit mësojnë të krijojnë burime multimediale që pasurojnë mësimdhënien digjitale. Moduli përfshin prodhimin bazë të videoeve, regjistrimin audio, parimet e dizajnit vizual dhe integrimin e mediave interaktive. Pjesëmarrësit mësojnë si të harmonizojnë përmbajtjen multimediale me objektivat e të nxënësve dhe si t'i integrojnë materialet në Moodle ose platforma të tjera.

Moduli 4 – Vlerësimi online

Ky modul trajnon mësimdhënësit për të dizajnuar vlerësime digjitale efektive duke përdorur kuize, detyra, mjete feedback-u dhe sisteme monitorimi online. Ai thekson vlerësimin formativ, integritetin akademik dhe harmonizimin e vlerësimit me rezultatet e të nxënësve. Gjithashtu, mësimdhënësit mësojnë strategji për krijimin e vlerësimeve fleksibile dhe të qasshme që mbështesin nxënës të ndryshëm në mjedise digjitale.

Moduli 5 – Sistemi i Menaxhimit të Nxënies (LMS – Moodle)

Një modul praktik i dedikuar ndërtimit dhe menaxhimit të kurseve online në Moodle. Mësimdhënësit mësojnë të strukturojnë module, të ngarkojnë burime, të dizajnojnë aktivitete interaktive, të integrojnë mjete të jashtme dhe të menaxhojnë progresin e nxënësve. Në fund të modulit, mësimdhënësit janë në gjendje të dizajnojnë dhe të udhëheqin në mënyrë të pavarur një kurs të plotë në Moodle.

Robotika duke përdorur Inteligjencën Artificiale

Ky modul i prezanton mësimdhënësit me robotikën e mbështetur nga IA si mjet për avancimin të nxënësve në STEM. Mësimdhënësit mësojnë si robotët edukativë mund të mbështesin zgjidhjen e problemeve, mendimin kompjuterik dhe kreativitetin. Moduli përfshin programim praktik të sjelljeve robotike dhe eksplorimin e koncepteve të IA-së, si njohja e modeleve dhe lëvizja autonome. Strategjitë e integritetit në klasë ndihmojnë në dizajnimin e aktiviteteve të robotikës në përputhje me kurrikulën.

Dizajni universal dhe arsimi STEM gjithëpërfshirës

I bazuar në kornizën UDL dhe udhëzimet për qasje digjitale, ky modul mbështet mësimdhënësit në dizajnimin e mjediseve gjithëpërfshirëse të të nxënit. Mësimdhënësit mësojnë të zbatojnë tri parimet e UDL-së, angazhimin, përfaqësimin dhe veprimin/shprehjen si dhe të rishikojnë standarde të qasjes si WCAG. Detyrat praktike përfshijnë vlerësimin e materialeve për paragjykimet, përshtatjen e burimeve për nxënës të ndryshëm dhe ristrukturimin e aktiviteteve STEM për të siguruar qasje për nxënës me dallime fizike, shqisore ose njohëse.

Mendimi kompjuterik në klasë

Ky modul i pajis mësimdhënësit me strategji për të prezentuar konceptet e mendimit kompjuterik, si dekompozimi, njohja e modeleve, abstraksioni dhe algoritme, në lëndë të ndryshme. Mësimdhënësit mësojnë të dizajnojnë aktivitete që zhvillojnë shkathhtësitë e zgjidhjes së problemeve, me ose pa pajisje digjitale. Moduli tregon se si mendimi kompjuterik mbështet arsyetimin logjik dhe përgatit nxënësit për kodim, robotikë dhe disiplina STEM.

Editimi i videove për mësimdhënie digjitale

Një modul praktik që trajnon mësimdhënësit në editimin e videove për qëllime mësimore. Pjesëmarrësit mësojnë teknika bazë si prerja, tranzicionet, përmirësimi i audios, titrimi dhe eksportimi i formateve të përshtatshme për nxënie online. Theksi vihet në prodhimin e videove të qarta, angazhuese dhe të harmonizuara pedagogjikisht, të përdorshme në klasa të përmbysura, tutoriale ose mjedise të të nxënit të kombinuar.

Robotë humanoidë dhe socialë në arsim

Ky modul eksploron përdorimin e robotëve humanoidë dhe socialë, si Pepper, NAO ose platforma të ngjashme në mësimdhënie dhe nxënie. Mësimdhënësit mësojnë se si robotët mund të mbështesin të nxënit e gjuhëve, zhvillimin socio-emocional, eksplorimin STEM dhe arsimin gjithëpërfshirës për nxënës me nevoja të ndryshme. Moduli përfshin programimin bazë të robotëve, dizajnimin e ndërveprimeve njeri–robot dhe krijimin e aktiviteteve mësimore ku robotët shërbejnë si asistentë, tutorë ose partnerë bashkëpunues në të nxënit.

Mirënjohje

Korniza e Kompetencës Digjitale për Mësimdhënësit në Kosovë, është një rezultat i projektit *Transformimi i Sistemit Arsimor në Kosovë dhe Shqipëri përmes Integrimit të Teknologjisë Digjitale në Edukimin e Mësimdhënësve (TKAEDiTE)*, i bashkëfinancuar nga programi Erasmus+ në kuadër të Veprimit 2 – Ndërtimi i Kapaciteteve në Arsimin e Lartë, Marrëveshja e Grantit nr. 101082862 – UP – ERASMUS-EDU-2022-CBHE.